

SPECIFIKIMIET TEKNIKE

VAJ IZOLUES MINERAL I PA PËRDORUR PËR TRASFORMATORË E FUQISE DHE ÇELËSA TË N/STACIONEVE

1. Përshkrimi teknik.

Vaj i transformatorit përftohet nga përpunimi i thellë i naftës. Ai ka qëndrueshmëri të lartë ndaj oksidimit, është izolues i nivelit të lartë dhe përdoret në pajisjet që punojnë dhe operojnë në temperaturë të lartë dhe që kërkojnë qëndrueshmëri të madhe ndaj oksidimit.

Vaj transformatori ka përmbajtje të ulët sqfuri, pikë të lartë flakërimi, aciditetin e ulët që ndikon në jetë gjatësine e pajisjeve ku do të përdoret. Viskoziteti i ulët lejon mirë dhe shpejt transmetimin e nxehtësisë.

E rëndësishme është që përmbajtja e PCB gjatë testimeve duhet të jete i pakapshëm nga aparatet.

Standarti i vajit izolues mineral të papërdorur është sipas IEC 60 296.

2. Përdorimi

Vaj i transformatorit, përdoret si izolues dhe material ftohës në transformatorët e fuqisë me vaj, çelësa me vaj , etj

3. Kërkesat

Vaj mineral izolues i papërdorur në përputhje me këtë standart duhet të plotësojë vlerat përkatëse të specifikuar në tabelën mëposhtë. Këto vlera duhet të kontrollohen dhe plotësohen vetëm për vaj izolues mineral të papërdorur, kur dorëzohet dhe para futjes së tij në aparate. Vaji duhet të ketë markim CE

4. Mënyrat e testimit

Pamja vizuale (paraqitja):

Paraqitja do të vlerësohet duke shqyrtuar një mostër përkatëse të vajit me një trashësi prej rreth 10 cm në dritë transparente dhe në temperaturën e ambientit.

Dendësia

Për këtë mund të përdoret çdo metodë e njohur Testimi. Por metoda që do të përdoret në rastet e kontestimit do të jetë sipas standartit ISO 3675.

Densiteti do të matet në temp. 20⁰C sipas formulës :

$$P_{20} P_t [1 X (t 20^0C)]$$

Ku : P₂₀- densiteti ne 20⁰C

t - temperature ne grade celcius

P_t- densiteti i matur në temperaturen t⁰C

X - Faktori korrektues = 65*10⁻⁵ (vlere e perafert)

Për saktësinë më të madhe, faktor korrigjimi duhet të përdoren nga lista e rekomanduar në ISO R/91

Tabela e vlerave të kërkuara

Karakteristikat	Njësia	St. Testit	Vlerat e kërkuara
1. Fizike			
Ngjyra			<0.5
Appearanca		IEC 60296	E qarte dhe e ndritëshme
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /S	ISO 3104	9.5
Viskoziteti në -30 °C	mm ² /S	ISO 3104	≤900
Pika e ngrirjes	°C	ISO 3016	-45
Densiteti në 20°C	kg/dm ³	ISO 12185	0.875
2. KIMIKE			
Aciditeti	mg KOH/g	IEC 62021	<0.01
Squfur koroziv		IEC 62535	jo
Përmbajtja e ujit	mg/kg	IEC 60814	<15
Antioksidant Wt	%	IEC 60666	<0.4
Përmbajtja aromatike	%	IEC 60590	10
Përmbajtja e sqfurit	%	ISO 14596	0.1
3. ELEKTRIKE			
Tensioni I çpimit Para trajtimit Pas trajtimit	kV	IEC 60156	60 >70
Faktori dielektrik I Shpërndarjes (DDF) tanδ ne 90 °C		IEC 60247	<0.001
Tensioni shtresë	mN /m	IEC 6295	45
Tendenca e gazit	µl/min		+10
4. STABILITETI I OKSIDIMIT			
Në 120°C, 500h		IEC 61125 C	IEC 61125 C
Aciditeti total	mgKOH/g		<0.3
Llumi (papastërtit)	Wt %		<0.02
5. Shëndeti, siguria dhe mjedisi			
Përmbajtja totale e PCB	mg/Kg	IEC 61619	E pa diktueshme
Pika e flakërimit, PM	°C	ISO 2719	145
Komponimet e nxjerëshme DMSO	Wt %	IP 346	<3

5. Kërkesa për ruajtjen, trajtimin dhe transportin

Vaji I transformatorit furnizohet ne fuçi 180-200kg, të cilat janë të vulosura me vulën e prodhuesit. Gjatë magazinimit dhe transportit duhet pasur kujdes që të mbahet larg nga flakët, ndezësave ose sipërfaqeve të nxehta. Produkti ruhet në ambiente të pastra dhe në enë të thata dhe të vulosura

hermetikisht kur nuk është në përdorim. Fuçite duhet të kenë etiketat përkatëse, ku është emri dhe adresa e prodhuesit, data e prodhimit, sasia, numri I kontratës.

6. Testet

Furnizuesi duhet të sigurojë seri të plotë të testeve të fabrikës, siç tregohet dhe përshkruhet me sipër.

7. Testet pas dorëzimit

Pasi malli të jetë dorëzuar, Blerësi ka të drejtat për të kryer teste në vend para pranimit të mallrave. Kostoja e këtyre testeve do të paguhet nga Shitësi. Nëse rezultati i testeve të kryera tejkalon shifrat e kërkuara, siç tregohet në tabelën më sipër, Blerësi ka të drejtë të refuzojë mallin.